



Copyrighted material



dr. Norman Cigar

**Roli i orientalistëve  
serbë për justifikimin  
e gjenocidit ndaj  
muslimanëve në Ballkan**



/The role of Serbian orientalists in justification  
of genocide against Muslims of the Balkans/

Copyrighted material



LEXO

Përkthyes:  
mr. Xhabir Hamiti  
Nig'jar Bajram-Hoti

Studi i kufimit bosnjugoskist,  
Uloga srpskës orientalistës e sprazhdancës  
genocida ndaj muslimanina na Ballkan  
The role of Serbian orientalists in justification  
of genocide against Muslims of the Balkans  
Institut za istraživanja zločina protiv  
čovjekostva i međunarodnog prava,  
Sarajevo, 2008  
ISBN e kufimit bosnjugoskist: 9958-740-12-5

dr. Norman Cigar

# Roli i orientalistëve serbë për justifikimin e gjenocidit ndaj musilimanëve në Ballkan

/The role of Serbian orientalists in justification  
of genocide against Muslims of the Balkans/

Të gjithë të drejtat jenë të reservuar.  
Kjo libri mund të llogaritet përdorur së përshtatshme  
Kjo informacioni përfshin përcaktuara të librit apo edhe përfshin të  
fotot e të cilat nuk përgjegjëse. Pse, nuk llogaritet raportet  
transmetuar nga këngëtari i tretë libri ndërtimtar që ka llogaritur përfshinë të llogaritë.



Copyrighted material



dr. Numan Cigar  
ROLI I ORIENTALISTËVE SERBË PËR JUSTIFIKIMIN E  
GENOCIDIT NDJAK MUSLIMANËVË NË BALLKAN

Boton: Logos-A

Përbetuesi: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Huseinmedin Ahazi

Redaktor gjyki: dr. Asllan Ramiti  
Redaktor artistik & dizajni: Edi Agagjshi  
Redaktor teknik: Arben Zaimi  
Faqesës: Nasir Fera

Mbikëqyrës i shtypit: Iner Gogajti  
Përgatitja kompjutante: Focus Pro - Shkop  
Shtypi: Focus - Prishtine

Copyright © Logos-A, 2003

Shtëpimi i CIP katalogut i librit është gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare e Universitare  
ISBN 9999-59-039-1

[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)

Copyrighted material

■ dr. Norman Cigar

■ **The role of Serbian  
orientalists in  
justification of  
genocide against  
Muslims of the Balkans**



■ Copyrighted material

D r . N o r m a n C i g a r

Roli i orientalistëve serbë për  
justifikimin e gjenocidit ndaj  
musilimanëve në Ballkan

The role of Serbian  
orientalists in justification of  
genocide against Muslims of the  
Balkans



# Biblioteka Mendimi

**Titulli i origjinalit:**

The role of Serbian orientalists in justification  
of genocide against Muslims of the Balkans

**Përktheu:**

---

---

Copyright © Logos, 2002

.....

Katalogimi në publikim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

ISBN 9951-417-

Këtë libër gjithashtu mund ta gjeni edhe në Bibliotekën tonë Elektronike në Internet adresën

<http://www.logos-a.com.mk/> \_\_\_\_\_

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht, për përdorim personal dhe jo fitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të lbrit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.

Por, nuk lejohet reprodukimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të botuesit.

**Dr. Norman Cigar**

---

**ROLI I ORIENTALISTËVE SERBË PËR  
JUSTIFIKIMIN E GJENOCIDIT NDAJ  
MUSLIMANËVE NË BALLKAN**



# Përbajtja:

Hyrje .....	9
Orientalistët serbë sigurojnë përkrahjen shkencore .....	10
Orientalizmi dhe nacionalizmi - zhvillimi i simbiozës .....	13
Nacionalizmi dhe opinioni shkencor në Serbi .....	13
Vala nacionaliste antiislamike .....	14
Trasimi i rrugës për gjenocid .....	17
Rreziku nga shpërthimi i frikës dhe i armiqësisë .....	17
Dallueshmëria si fatkeqësi - vënia e kufijve etno-kulturorë .....	19
Muslimanët si të dorës së dytë .....	20
Islami si mbeturinë e së kaluarës .....	23
Islami dhe dhuna .....	25
Muslimanët si tradhtarë .....	27
Izolimi i muslimanëve .....	30
Bashkësia e delegjitimuar .....	31
Muslimanët kërcënues ekzistencial për çdo gjë .....	33
Kërcënim i përhershëm .....	33
Komploti i muslimanëve kundër Serbisë dhe Perëndimit .....	37
Misioni paralajmërues .....	42
Nga analiza deri te avokatura - arsyetimi i gjenocidit .....	47
Konluzionet dhe implikacionet .....	51
Roli dhe përgjegjësia e orientalistëve .....	51
Gjasat për ardhmëri .....	55

## **Contents:**

<b>Introduction .....</b>	<b>61</b>
<b>Serbian Orientalists Providing the Scholarly Reassurance.....</b>	<b>62</b>
<b>Orientalism and nationalism: developing the symbiosis .....</b>	<b>65</b>
<b>Nationalism and Scholarship in Serbia .....</b>	<b>65</b>
<b>The Anti-Islamic Drift of Nationalism.....</b>	<b>66</b>
<b>Paving the way for genocide .....</b>	<b>69</b>
<b>The Risk of Fanning Fear and Hostility .....</b>	<b>69</b>
<b>Diversity as an Evil: Setting the Ethno-cultural Boundaries.....</b>	<b>71</b>
<b>Muslims as Aliens.....</b>	<b>72</b>
<b>Islam as a Remnant of the Past.....</b>	<b>74</b>
<b>Islam and Violence.....</b>	<b>76</b>
<b>Muslims as Traitors.....</b>	<b>78</b>
<b>Isolating the Muslims .....</b>	<b>80</b>
<b>A Delegitimized Community .....</b>	<b>81</b>
<b>The muslims as an existential threat to everything .....</b>	<b>83</b>
<b>The Permanent Built-in Threat.....</b>	<b>83</b>
<b>The Muslims' Conspiracy Against Serbia and the West .....</b>	<b>86</b>
<b>The Waring Mission .....</b>	<b>91</b>
<b>Transitioning from analysis to advocacy: justifying genocide .....</b>	<b>97</b>
<b>Conclusion and implications .....</b>	<b>101</b>
<b>The Role and Responsibility of the Orientalists.....</b>	<b>101</b>
<b>Outlook for the Future .....</b>	<b>104</b>



## Hyrje

Bashkësia muslimane e ish-Republikës jugosllave të Bosnjës dhe Hercegovinës është viktimë e asaj çfarë mund të shënohet me gjenocid, sipas çfarëdo normeje të pranueshme juridike dhe morale. Shkaktari dhe qendra e kësaj tragjedie është ideologjia nacionaliste serbe, e ngjyrosur rreptësisht dhe e inspiruar me orientalizmin të kuptuar gjërësisht në kuadër të mendimit gjithpërfshirës, me orientalizmin si mishërim dhe sulmues i fortë i një procesi të shënuar me ndarjen maniheike në “ata” dhe “ne”, siç e ka porositur këtë Edvard Said në veprën e vet pioniere për këtë fenomen.<sup>1</sup>

Me siguri, lidhja mes shkencës dhe pushtetit nuk është e re duke marrë parasysh që orientalistët ishin të shfrytëzuar dhe të përdorur në vende dhe kohë të ndryshme, që ta sqaronin dhe ta përkrahnin politikën shtetërore ndaj muslimanëve.<sup>2</sup> Ndërkaq, rrallëherë orientalizmi ka pasur lidhje direkte me politikën, çfarë ka pasur me politikën e “spastrimit etnik”, siç quhet zakonisht procesi i gjenocidit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

---

<sup>1</sup> Edward W. Said, *Orientalism* [Orientalizmi], botim special, New York, 1979.

<sup>2</sup> Shiko p.sh. Stuart Schaar, *Orientalism at the service of imperialism*, [Orientalizmi në shërbim të imperializmit] *Race and Class*, Vera, 1979, faqe 67

## **Orientalistët serbë sigurojnë përkrahjen shkencore**

Orientalistët serbë zakonisht nuk do t’ia tërheqnin vëmendjen dikujt tjetër, përveç de një vëmendje kalimtarë. Dituria e tyre është e pavlerë, numri i tyre është mu ashtu si edhe efekti i tyre i vogël. Ndërkaq, ajo që i bën të njohur për të keq është politika e tyre dhe qëndrimi i tyre ndaj muslimanëve boshnjakë. Ata ishin në vijën e parë të frontit të lëvizjes antiislamike ende nga viti 1980 dhe dukshëm i kanë kontribuar gjenocidit kundër muslimanëve, duke e krijuar dhe duke e bërë të përshtatshëm dhe të pranishëm këtë proces në të gjitha shtresat e shqërisë serbe.

Në qendër të këtij studimi është Bosnja dhe Hercegovina për shkak të përmasave të viktimate që ndodhën aty, ndonëse konkluzionet e njëjta, gjithashtu vlejnë edhe përvendet e tjera të ish Jugosllavisë me popullatë të madhe muslimane, siç është Kosova, Sanxhaku dhe vet Serbia.

Shënimet dhe deklaratat publike të orientalistëve serbë në kohët e fundit praktikisht përherë ishin ngusht të lidhura me kontekstin dhe qëllimet politike. Fakti që duke sulmuar në mënyrë intelegrante Islamin dhe muslimanët, kanë pasur për qëllim të sigurojnë mbështetje të dukshme për ideologjinë nacionaliste e cila ishte shumë e shprehur. Kjo, që këta shkencëtarë shpesh ishin të lutur nga Beograd i dhe nga pushtetmbajtësit e serbëve bosnjakë dhe nga qeveria me media të kontrolluara që t’ua ‘sqarojnë’ dhe publikut t’ia ‘arsyetojnë’ politikën oficiale qeveritare ndaj muslimanëve, përkrah kësaj është tregues i qartë që kryesia e ka vërejtur dobishmérinë e përkrahjes së tillë të ekspertëve dhe ka pritur që ky bashkëpunim do të jetë i mirëpritur me dëshirë.

Në qarqet akademike serbe ndonjëherë nuk ekziston distinksion i qartë për atë se cili është “orientalist”, meqë shumë shkenctarë të shkencave humane dhe shoqërore shpeshherë merren me islamin kur shkruajnë mbi temat e shumta historike dhe politike duke e pasur parasysh lidhjen e pashmangshme me çështjet serbe gjatë gjashtë shekujve të fundit. Ndonëse këtu fokusi nuk është në këtë rrjet të gjerë shkencëtarësh, të cilët çështë e vërteta, edhe nuk janë duke u marrë vazhdimisht me Islamin dhe, me profesion nuk janë ekspertë të tij, por, gjithsesi ndikojnë mbi politikën islame dhe kontribuojnë në formimin e opinionit intelektual dhe publik, kur për tematikën islame është shtuar interesimi. Ata, po ashtu, lëndës së vet iu qasen me qëndrim armiqësor, i cili fare pak dallohej nga qëndrimi i orientalistëve profesionalë. Por, megjithatë, pak a shumë, orientalistët “profesionalë” janë ata të cilët mbajnë përgjegjësi të veçantë për atë që mund të argumentohet, pikërisht ata janë që më tepër sesa populli i Serbisë, është dashur ta dinin, ndoshta edhe më së miri, se çfarë pasojash do të mund të kishte interpretimi i Islamit prej tyre.



## **Orientalizmi dhe nacionalizmi - zhvillimi i simbiozës**

### **Nacionalizmi dhe opioni shkencor në Serbi**

Politzimi i orientalistëve serbë dhe roli i tyre publik shtoheshin paralelisht me rritjen e lëvizjes nacionaliste gjatë viteve të tetëdhjeta të këtij shekulli. Nëse do të kishte moment të caktuar dhe katalizator të perceptuar për një varg ngjarjesh në ish Jugosllavi, atëherë ky do të ishte Memorandumi i shpallur në vitin 1986 nga Akademia e shkencave dhe e arteve serbe. I hartuar nga intelektualët udhëheqës serbë, të cilët për vete kanë ëndëruar rol më të rëndësishëm në shoqëri dhe në politikë, memorandumi ka kristalizuar përtëritjen dhe ringjalljen e qëllimeve më të hershme nacionaliste serbe, nga të cilët formimi i Serbisë së Madhe ishte paradigmë shtytëse.

Gjithashtu, Memorandumi ka përgatitur terrenin për shpërthimin e dhunës, meqë implemetimi i tij përbante zgjerimin territorial dhe ekskluzivitetin etnik. Kjo kërcënonë sigurinë themelore, madje edhe ekzistimin e bashkësive jugosllave, përveç nëse bashkësítë e tjera jugosllave pasivisht do t'i pranonin implikimet parashikuuese të Memorandumit. Ky skenar i pamundur Memorandumi do të ishte realizuar vetëm me përdorimin e dhunës, në sajë të Slobodan Milosheviqit. Komunistit serb në ngritje,

komunistët në pushtet lidhën martesë aleate me serbët jokomunistë, me nationalistët dhe me Kishën Ortodokse serbe. Me këtë rast u krijua simbioza e Kuqe-Gështenjë dhe e Zezë, e cila siguroi lëvëzjen fillestare dhe strukturën e nacionalizimit serb.

Milosheviqi ishte ai i cili jo vetëm që i ka futur nationalistët në rrymën kryesore politike, por, gjithashtu, e ka siguruar makinerinë në formë të organizimit politik, medias, ndihmës financiare, forcës ushtarake; e cila i transformoi sentimentet sa po tē filluara në programin konkret shtetëror, i cili do tē mund tē zbatohej në terren.

## **Vala nacionaliste antiislamike**

Në fund të viteve të tetëdhjeta të këtij shekulli, pushteti serb, nationalistët, mediat popullore dhe Kisha Ortodokse serbe, haptas të gjithë së bashku u bënë armiqësisht të disponuar ndaj islamit, ndërsa incidentet e aranzhmanit antimusliman dramatikisht shtoheshin. Në vend që t'i gjykonin trendet e tilla, nationalistët serbë ato i mbështetnin dhe i arsyetonin, por edhe vet ata shpesh ofronin urrejtje të mëtutjeshme antimuslimane.

Me siguri, akademikët serbë, gjithashtu i sulmonin edhe etnititetet e tjera, duke përfshirë edhe Kroatët, Shqiptarët, Romët, Sllovenët dhe Maqedonasit, gjatë viteve posa të kaluara, me kampanjat e veta negative të themeluara mbi paraqitjet stereotipe të përcjella me mesazhe për ndërmarrjen e masave të vendosura. Ndonëse, muslimanët nuk ishin të vetmit në këtë pikëpamje, me gjithatë ata si bashkësi ndoshta ishin veçanërisht të lënduar dhe të ekspozuar sulmeve të tilla intelektuale në

mes rrrethanave specifike gjeopolitike, e atillë siç ishte pozita e tyre e cila e pengonte krijimin e Serbisë së Madhe. Kjo, gjithashtu e ka shtuar mundësinë që muslimanët të jenë cak i sulmeve të vazhdueshme fizike, e që, përsëri e ka për qëllim shpërnguljen e tyre.

Në masë të madhe përshkrimi negativ i ndonjë bashkësie të caktuar ishte i udhëhequr nga elita serbe, si përgjigje në qëllimet konkrete politike, të cilat muslimanët dhe joserbët e tjerë ua pamundësonin me vet prezencën e tyre.

Ndërkaq, fokusi specifik politik në çdo moment të veçantë orientonte, prandaj edhe orientalistët serbë e harmonizonin aktivitetin e vet me nevojën specifike momentale. Gjatë vitit 1980 për Serbinë çështja më e rëndësishme ishte Krahina Autonome e Kosovës, banorët e së cilës shumica janë shqiptarë muslimanë, prandaj shkrimet më të hershme të orientalistëve ishin të përqëndruara mbi Islamin, me qëndrim specifik ndaj Kosovës. Më vonë kur theksi politik u lëkund, faktori islamik në Bosnjë dhe Hercegovinë shpejt filloi të bëhej i rëndësishëm, duke e provokuar paralelisht refokusimin nga ana e orientalistëve serbë.



## **Trasimi i rrugës për gjenocid**

### **Rreziku nga shpërthimi i frikës dhe i armiqësisë**

Në vend që ta promovojnë atmosferën e bashkëjetësës dhe zgjedhjes paqësore, orientalistët serbë kanë luajtur rol të rëndësishëm në shtimin e vajit në zjarr dhe në rritjen e frikës dhe urrejtjes në mes bashkëvendasit të vet serbë. Shumë më parë, para shkatërrimit të vërtetë të Jugosllavisë, këta shkencëtarë filluan të formojnë imazh stereotip mbi muslimanët si faktor i huaj, inferior dhe kërcënues. Duke e mbrojtur politikën e ashpër, me të cilën duhet vepruar gjatë marrjes me etnitë islame, ata ndihuan që në mesin e serbëve në lidhje me muslimanët të krijohet situatë e paranojës së futur.

Në fazën e përgatitur është zhvilluar krijimi i atmosferës antiislamike, e cila e mundësoi rrëshqitjen e mëtujeshme në gjenocid, pasi që shpërtheu përlleshja e hapët në Bosnjë dhe Hercegovinë, në prill të vitit 1992. Përhapja e armiqësisë ndaj muslimanëve ishte papërgjegjësi e veçantë duke pasur parasysh leksionin e hidhur nga Lufta e Dytë Botërore, gjatë së cilës janë zhdukur me qindra mijëra viktima në përlleshje të ndërsjelltë.

Muslimanët tani një herë ishin viktima të spastrimit etnik, i kryer me duart e nationalistëve çetnikë së bashku me lëvizjen e tyre në përpjekje për krijimin e Serbisë së

Madhe.<sup>3</sup> Një fushatë e ringjallur antiislame për përkrahjen e qëllimeve të njëjtë politike serbe, të cilat e udhëheqnin politikën serbe jo vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishte e denuar që për bashkësinë muslimane të rrezikojë përsëritjen fatkeqësisë së njëjtë.

<sup>3</sup> Karakteristikë qenësore, qysh në vitin 1844, e projektit të konstituar “Serbia e Madhe” dhe vendosja e homogenitetit të tij në Ballkan është krijuim etapor. Në prag të Luftës së Dytë Botërore bartësit ideor të lëvizjes ishin shtabi gjeneral ushtarak dhe klubi kulturor serbë. Jugoslovenizmin integral e konsideronin dështim i Aleksandrit, andaj preferonin tubimin e (vendeve) tokave serbe në tërësi territoriale. Kur kjo tërësi bëhet homogjene do të bëhet hegemoni i paprekshëm në Jugosllavi, me çka mundësohet hegemonia serbe edhe në Ballkan. Mbi këtë bazë është zbatuar fashizacioni i vendit dhe të përshtaturit me Gjermaninë, çka me 25 mars në vitit 1941 sjell deri te kyqja e Jugosllavisë në Paktin Tripalësh, ndërsa Lufta e Dytë Botërore është konsideruar si rast për realizimin e planit. Me organizmin e puçit më 27 mars 1941 shërbimi sekret i Britanisë i ngatërrroi këto llogari dhe e ndan Lëvizjen, bile, në dy fraksione. Pas kapitullimit të vendit, i pari iu mbështet okupatorit gjerman dhe në vend e ka marrë pushtetin kolaboracionist. Në kuadër të tij gjendej edhe *organizata paralitarake çetrike* me Kosta Peçanin në krye. I dyti e zgjodhi hundrimin (lavirimin) në mes okupatorit dhe Britanisë së Madhe, ndërsa bërtanën e perbën një grup oficeresh, që i ishin shmançur robërimit dhe ishin tubuar në (Pyllin e rrashët) Ravna gora. Në krye e kishte kolonelin e shërbimit të informimit, Drazha Mihajloviqin dhe ishin quajtur “*çetnikë ushtarakë*”. Aktivizimi i lëvizjes nacionalçirimitare dhe pranimi nga ata i bashkëpunimit me këtë grup edhe asaj ia shtoi imigjin e luftës dhe e përforcoi dukshëm. Ndërkaj, qëllimi i tij nuk ishte konfrontimi me okupatorin, por përgatitja e forcave për “*momentin joprezent*” në të cilin “*Serbia e Madhe*” do të jetë e “*kufizuar*” dhe pastaj e spastruar “*nëgjësia e joserbëve*”, prandaj, shkëputja me lëvizjen nacionalçirimitare dhe bashkëpunimi me okupatorin ishin të pashmangshëm.

Operacionalizimi i qëllimeve të përmendura më lart është në dy dokumente bazë: Rekonstruksioni i projektit të Stevan Moljeviqit 30 qershor “*Serbia homogene*” dhe *Instrukzioni i Drazha Mihajloviqit prej 20 dhjetorit të vitit 1941* (e shtypur në *Përmledhjen e dokumentacionit dhe të dhënave, lidhur me luftën nacionalçirimitare të popullit të Jugosllavisë*, vëllimi XIV, libri 1, faqe 1-10 dhe 93-103), ndërsa zbatimi i veprimeve gjenocide të dokumentuara me mijëra dokumente autentike me provenienca të ndryshme. Më të rëndësishmit janë të pëmbajtur në faqën 4.333 vëllimi XIV, të *Përmbledhjes* të përmendur, botimi i Institutit të Historisë Ushtarake, Beograd më 1981-1985. Çetnikët, gjatë katër viteve të realizimit të qëllimeve të veta, i kanë vrasë me qindra njerëz nga popullata joserbe por edhe bashkëvendas të vet. Lidhja definitive e çetnikëve me okupatorin dhe fitoja e Lëvizjes Nacionalçirimitare e kanë pamundësuar realizimin e tërësishëm të Planit.

## **Dallueshmëria si fatkeqësi - vënia e kufijve etno-kulturorë**

Njëra nga të ‘arriturat’ kyçë të orientalistëve serbë ishte diferencimi dhe izolimi i bashkësisë muslimane, konstatimi dhe vënia në spikame e karakteristikave të cilat fokusoheshin mbi Islamin dhe muslimanët si ekzotikë – natyrisht, në mënyrë negative, sulmuese dhe automatikisht si inferior, madje me përmasa jonormale! Që më lehtë t’i gjykonin muslimanët, më me dëshirë se t’i përshkruanin dhe t’i analizonin, orientalistët serbë – kryesisht në të njëjtën mënyrë si në procesin, i cili është në fokusin e Orientalizmit të Edvard Said-it – e kanë krijuar një tip të islamit të prishur dhe stereotip musliman, i cili mund të modifikohet ashtu që muslimanët të izolohejshin dhe të sulmoheshin! Në të njëjtën kohë orientalistët gjithashtu, mund ta shfrytëzonin këtë musliman të prishur dhe të ndryshuar si mjet nëpërmjet të të cilët mobilizonin përkrahje në mesin e përkrahësve të vet. Si pjesë e kësaj procedure, orientalistët serbë në mënyrë konsekutive, e shtrembëronin Islamin dhe qëllimisht deformonin Islamin, situatën dhe qëllimet e etnisë muslimane. Ajo që më vonë u shfaq ishte dihotomia e fortë në mes serbëve dhe muslimanëve, me atë që këta të dytët ishin mveshur, me të gjitha karakteristikat e mundshme negative, të cilat vështirë se mund të imagjinohen, të përshkruara si “të huaja”, pastaj të degraduar në pozitën e inferioritetit kulturor dhe moral. Me të vërtetë revista e ushtrisë së Republikës Federative të Jugosllavisë ka kërkuar nga profesori Darko Tanaskoviq, ekspert për studimet islame në universitetin e Beogradit, të cilin ditari beogradas Politika, i kontrolluar nga shteti, e quan “udhëheqësi ynë islamolog”, kishte për detyrë që për lexuesit e

tij, enkas të analizojë dallimin në mes “atyre” dhe “nëve”, muslimanëve dhe të krishterëve.<sup>4</sup>

## Muslimanët si të dorës së dytë

Tretmani të cilit i janë ekspozuar islami dhe muslimanët nga orientalistët serbë në shumëçka përputhet me atë që është e përbashkët me orientalistët tradicionalë të Perëndimit. Siç e thotë këtë një ekspert, esenciale është të krijohet “pikëpamja e kundërt me Perëndimin parodigmatik (Oxforden), pra depon e negativitetit, si negativitetë abstrakte ashtu edhe negativitetë të veçanta (te kulturat e tjera) në krahasim me ato okcidentale/perëndimore.”<sup>5</sup> Me fjalë të tjera, për orientalistët serbë, islami nënkuqtohet si diç, nga gjinia e kundërt, negative, e prapambetur, e huaj, jomorale, agresive; si diç që është në kundërshtim me të gjitha gjërat pozitive që mund të gjenden në kulturën serbe! Prezentimi negativ i muslimanëve ka filluar më 1980 dhe është shpeshtuar dukshëm pas shpërthimit të përleshjeve të vërteta më 1992.

Fillesa kyçe e kampanjës orientalistike është përqëndruar mbi idenë që muslimanët i takojnë një religjioni dhe kulturës ekzotike e të huaj dhe kështu - pason përfundimi – ata kurrë nuk do të kishin pasur vend në Evropë! Sipas kësaj, muslimanët kinse deri diku kanë më pak legitimitet që të jetojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë sesa serbët,

<sup>4</sup> Intervistë me Darko Tanaskoviqin nga Aleksandër Tomiqin, *Evropa nécé izbuci demografski Džihad* [Evropa nuk do d'i shpëtojë xhihadit demografik], *Vojška*, Beograd, 23 shtator 1993, faqe 8. *Vojška* ishte gazetë zyrtare në shërbim të Ushtrisë së Republikës Federale të Jugosllavisë.

<sup>5</sup> Aziz Azmeh, *The articulation of Orientalism* [Artikulimi i orientalizmit], *Arab Studies Quarterly*, Vjeshtë, 1991, faqe 386-387.

përkundër faktit që pikërisht muslimanët janë popullatë autoktone, ndërsa serbët janë ata që kanë ardhur.

Në fund të viteve të tetëdhjeta të këtij shekulli, për shembull, një orientalist serb, Aleksandër Popoviq edhe pse ligjëron në Paris, e ka shkruar pamfletin të publikuar në Beograd për ta informuar mbi islamin “publikun e arsimuar”. Ai këtë e ka parë si detyrë të vështirë, për arsyet se islam i është, pohon ai, “një sistem totalitar, totalitarizmin e të cilët larg e tejkalon ajo çfarë një shpirt qëllimmi rë dhe i painformuar perëndimor mund të kuptojë apo të imagjinojë.”<sup>6</sup> Tanaskoviqi në fryshtë të njëjtë merr rol aktiv në debatin i cili shpërtheu rrëth rregullave dijetale për muslimanët të cilët shërbejnë në Armatën Popullore Jugosllave. Gjatë periudhës komuniste, ngrënia e mishit të derrit në armatën Jugosllave shpeshherë shfrytëzohej si “test joformal i lojalitetit” për muslimanët që të tregonin sesi nuk janë të dhënë pas religionit. Në situatë të tillë, muslimanët shpeshherë kishin pak zgjedhje, gjegjësisht: ose të hanë mish derri ose të vuajnë për bukë derisa janë duke e shërbyer afatin e vet ushtarak. Kur ky problem shpërtheu në sipërfaqe, në fund të viteve të tetëdhjeta të këtij shekulli, Darko Tanaskoviq si edhe orientalistë të tjerë, shfrytëzuan këtë rast që t'i përshkruanin dhe t'i prezantonin muslimanët si element i humbur në shoqëri, duke i përqeshur kërkesat e muslimanëve për ushqim të veçantë dhe për vende të ndara për namaz. Tanaskoviqi madje pohon që nëse muslimani refuzon të hajë mish derri dhe shkon i uritur, kjo do të bëhet nxitje për separatizmin politik dhe do ta prish unitetin e ushtrisë. Personeli serb i njësimit, thjesht do të “rrënqetet” nga shërbimi me shokë të tillë asocial.<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Aleksandar Popović, *Jugoslovenski muslimani* [Muslimanët jugosllav], *Akvarijus*, Beograd, 1990, faqe 5.

<sup>7</sup> Darko Tanasković, *Između Kur'ana i kazana [Në mes Kur'anit dhe kazanit]*, NIN 25. korrik, 1989. fage 23.

Në përgjithësi, Tanaskoviqi ishte shqetësuar bukur shumë me mohimin e asaj çfarë kishte parë ai si përpjekje e muslimanëve të Bosnjës dhe Hercegovinës për të argumentuar se ata janë popull i vjetër evropian.

Tanaskoviqi konsideron që kjo është “natyrisht, absurditet notorn.”<sup>8</sup>

Një pseudoshkencëtar tjetër serb, Nada Todorov, kinse është duke i parë muslimanët në Bosnjë dhe Hercegovinë se si janë të motivizuar me “mënyrën e jetesës së tyre islame, e cila me civilizimin evropian nuk ka kurrfarë pikash puqëse.”<sup>9</sup>

Në thelbin e këtij problemi sipas Miroljub Jevtiqit, politologut dhe specialistit për Islam në Universitetin e Beogradit, gjendur natyra e huaj dhe themelë religjioz për “imperializmin kulturor arab”, i cili i determinon pikëpamjet e muslimanëve të këtushëm, mbi botën, por edhe fakti që sot arabët, kinse “kanë sukses në imponimin e kulturës së tyre, si kulturë me vlerë universale të cilën e ka krijuar Zoti dhe për të cilën njerëzimi nuk ka çfarë të thotë.”<sup>10</sup> Sipas Jevtiqit, kjo paraqet vështirësinë e pazgjidhur sepse:

“Ju, mund të luftoni kundër imperializmit kulturor Amerikan, sepse atë e krijuan njerëzit, amerikanët, momentalisht më të pasurit, por ata janë vetëm njerëz sikurse edhe ju. Ndërkaq, në islam, nëse dëshironi të keni lidhje me Zotin, këtë mund ta bëni vetëm në gjuhën arabe. Nuk janë Arabët të cilët këtë ua kanë urdhëruar. Kë-

<sup>8</sup> Intervju me Tanaskoviçin, *Vojška*, op. cit., 23 shtator, 1993, faqe 10.

<sup>9</sup> Intervju me Nada Todorov, intervistuar nga koloneli Nikola Ostojić, *Genocidne poruke iz "1001 noći"* [Mesazhe gjenocide të "1001 netëve"], *Vojška*, 8 prill 1993, faqe 20.

<sup>10</sup> Miroljub Jevtić, *Rezervisti All-llahore vojske* [Rezervistët e ushtrisë së Allahut], *Duga*, Beograd, 9-22 dhjetor, 1989, faqe 22. *Duga* përkrah mendimet e nationalistëve serbë të “visë së fortë”.

të e ka thënë Zoti? Ai i pranon lutjet vetëm të shqiptara në gjuhën arabe.”<sup>11</sup>

Për Jevtiqin, me të vërtetë nacionalizmi dhe disa nacione të tjera, të cilat ai është duke i parë ekivalente me diç perëndimore, nga njëra anë dhe islamin nga ana tjetër, reciprokisht janë ekskluzive. Kështu ai e dënoi nacionalizmin në Kosovë dhe pohon që ky është në të vërtetë, front për fundamentalizmin islam, sepse shqiptarët janë “evropian të rrejshëm, ndërsa muslimanë të vërtetë.”<sup>12</sup>

## Islami si mbeturinë e së kaluarës

Jo vetëm që islami është përshkruar në veprat e “orientalistëve” serbë si diç e huaj, e panjohur, por gjithashtu edhe i prapambetur. Ashtu siç këtë e kanë bërë orientalistët evropianë të kohës së hershme kolonialiste dhe shumica e kolegëve të tyre serbë, islamin e kanë shënuar si retrogrades dhe si shkaktar themelor, kërcënues i “civilizimit modern” si në pikëpamje të përgjithshme, ashtu edhe konkrete kur është në pyetje Serbia. Çdo akuzë e cila do të mund të shërbente që të nxihej islamit dhe që të izoloheshin muslimanët ishte e pranuar. Për shembull, Nada Todorov, deklaron se “në të mësuarit e islamit asnjë grua nuk ka shpirt dhe shërbën ekskluzivisht për të kënaqur nevojat e mashkullit dhe t'i shërbujë atij.”<sup>13</sup> Në mënyrë të njëjtë Tanaskoviçi thekson që

<sup>11</sup> Jevtiqi, *Duga*, op. cit., 9-22 dhjetor 1989, faqe 22.

<sup>12</sup> Miroslav Jevtić, *Lakrdja za Evropu* [Gjë qesharake për Evropën], *Evropske novosti* (Frankfurt, Gjermani), 22 dhjetor 1993, faqe 2. *Evropske novosti* është gazetë evropiane e ditarit të beogradit *Vesernje Novosti* e botuar në Gjermani për të shmangur sankcionet ndërkombëtare ndaj Serbisë.

<sup>13</sup> Intervistë me Nada Todorov, *Vojška*, op. cit. 8 prill 1993, faqe 21.

udhëheqësia vendase muslimane fshehurazi dhe në mënyrë klandestine i nxitë pasuesit e vet që t'i kthehen kinse vetëdijës së mëhershme inferiore, lidhjeve të përforcuara me bashkëfetarët e tyre në vendet e jashtme. Ose, siç e thotë këtë Dorko Tanaskoviq duke pyetur me retorikë:

“Pashmangshëm shtrohet pyetja, se a e kanë me të vërtetë këta përfaqësues të popullit musliman, edhe pse janë të zgjedhur në mënyrë demokratike, të drejtë dhe mandat që vëllezërít e vet sot, në fillim të shekullit njëzet e një, në sytë e Jugosllovenëve të tjerë, nga statusi i fituar si komb i pavatur në formë të pakontestueshme t'i kthejnë në pozitën e renegatëve nga kohët e kaluara.”

Tanaskoviçi e përfundon këtë akuzë të vet me kriticizmin të njojur mirë ndaj konvertitëve në islam, madje edhe të atyre të parëve, të cilët kanë kaluar në islam shumë shekuj më parë.

“Ndërsa paturi, dihet, më i keq se Turku.”<sup>14</sup>

Me siguri, Jevtiqi është proponenti më aktiv i ideve të këtilla. Tipike për të, ai pohon që “fundamentalistët islamë” për atë janë etiketim të cilin ai e vë lirisht mbi muslimanët, nuk janë asgjë më tepër përveç reflektimit të “së kaluarës së errët” dhe që “të kuptuarit e sklavopronarisë dhe barazisë nga ata nuk është i atillë siç e trajton njeriu i civilizuar, por siç e trajton Zoti i tyre.” Kinse, Islami e urdhëron ndalesën e turizmit, sportit, vajtjen në kafiteri ku shërbehet alkooli, sipas kësaj, kjo në mënyrë të pashmangshme shpie në ksenofobi “segregacionizmin qindpërqindësh”. “Sepse, nëse ju me fqiun tuaj i cili nuk është i fesë suaj nuk mund të hani së bashku, nuk varroseni në të

<sup>14</sup> Darko Tanasković, *Turi brane Sarajevo* [Turqit e mbrojnë Sarajevën], *Epoza* (Beograd), 7 janar 1992, faqe 21. *Epoza* botohet nga partia Socialiste e Serbisë në pushtet.

njëjtat varreza, nuk mund të lidhni marrëdhënie martesore, atëherë çfarë mundeni?” – pyet Jevtiçi me retorikë.<sup>15</sup>

Jevtiqi më tutje i vendos muslimanët jashtë kufijve të koekzistencës, duke e pasqyruar islamin si të huaj dhe të larguar. “Ashtuqë nuk ka as mëshirë, as joviolencë ndaj atyre që kanë mendim të kundërt me doktrinën e vlefshme islame.”<sup>16</sup>

Orientalistët serbë, gjithashtu, pohojnë që islami e urren çdo gjë që është joislame. Për Nada Todorov, “kjo gjithsesi është e vërtetë kur është në pyetje Serbia, sepse islami i nënçmon fetë e tjera, e veçanërishtë ortodoksizmin.”<sup>17</sup> Tanaskoviqi, në mënyrë të njëjtë përfundon që “feja islame nga shumica (në Serbi) ende përjetohet si e huaj, madje edhe armiqësore.”<sup>18</sup>

## Islami dhe dhuna

Në mënyrë të veçantë islami është pasqyruar si dhunues inherent. Jevtiqi, për shembull, pohon që “Alija Izetbegoviqi ka pohuar qartë që ai nuk dëshiron paqe dhe që ai nuk mund ta pranonte atë. Me këtë do ta kishë mohuar përkatësinë e vet islamike.”<sup>19</sup>

<sup>15</sup> Miroljub Jevtić, *Duga*, op. cip. 9-22 dhjetor 1989, faqe 21.

<sup>16</sup> Miroljub Jevtić, *Oproštaj bez milosti* [Ndarje pa mëshirë], *Europske novosti*, 7 korrik 1993, faqe 2.

<sup>17</sup> Intervistë me Nada Todorov, *Vojška*, op. cit., 8 prill 1993, faqe 21.

<sup>18</sup> Darko Tanasković, *Nacija i vera između ‘m’ i ‘M’* [Kombi dhe Feja ndërmjet “m” i “M”], NIN, Beograd, 24 shtator 1989, faqe 25. Në atë kohë, NIN-i mbështete pikëpamjet sunduese të Milosheviqit.

<sup>19</sup> Miroljub Jevtić, *Nema mira u Bosni* [Nuk ka paqe në Bosnë], *Europske novosti*, 28 dhjetor 1993, faqe 4.

Që të arsyetohej politika e tanishme në Bosnjë dhe Hercegovinë, është theksuar vështrimi statik mbi Islamin. Për shembull, kur ministri për çështje fetare i Malit të Zi e ka paraqitur mendimin, që religionet monoteiste, duke e përfshirë edhe Islamin, për bazë e kanë jodhunën, faljen zemërgjerë, dhembshurinë dhe humanitetin, Jevtiqi kishte nxitur ta përmirësonte atë duke pohuar që veçoritë e tilla padyshim nuk janë karakteristika të Islamit, duke e bazuar mendimin e vet mbi të lexuarit e vëçantë të Kur'anit.<sup>20</sup> Ngjashëm me këtë, por edhe që ta sqaronte kinse këtë prirje për dhunë, Tanaskoviqi e fajëson “tonin e Kur'anit i cili është shprehimisht urdhërues, pakundërshtiues dhe kërcënues.”<sup>21</sup>

Shpjegimi i Jevtiqit për kinse gatishmërinë e muslimanëve për vrasjen e të tjera e përqëndrohet mbi edukatën e tyre fetare. Duke shkruar në shtyp në fund të vitit 1993, ai sqaron:

“Me islam është përcaktuar qartë që besimtarët e tij duhet të therin kafshë në emër të Allahut. Kjo kafshë është berr, i cili theret në mënyrë rituale, ashtu që në çdo anë shpërthen gjaku i kafshës së sakrifikuar. Nëse përkatësit e civilizimit islam që nga fëmijëria mësohen për të parë qengja të therur, të cilët për çdo njeri janë kafshët më të dashura, atëherë është e qartë që njeriu, i cili e respekton urdhërin e shenjtë adaptohet lehtë në derdhjen e gjakut në mënyrë shumë mizore. Ndërsa nga vrasja e kafshëve deri te vrasja e njeriut nuk është hap i madh.”<sup>22</sup>

Sipas mendimit të Nada Todorovit, analizat e së cilës janë publikuar në shtypin ushtarak, tregimet tradicio-

<sup>20</sup> Miroljub Jevtić, *Europske novosti*, op. cit., 7 korrik 1993, faqe 2.

<sup>21</sup> Intervistë me Tanaskoviqin, *Vojška*, op. cit., 23 shtator 1993, faqe 8.

<sup>22</sup> Miroljub Jevtić në *Jarnost* (Sarajevë), cituar në rubrikën “Ljudi i vremë /Njërit dhe kohaj”, *Vreme*, Beograd, 15 nëntor 1993, faqe 55. *Vreme* është javore e opozitës liberale.

nale Njëmijë e një netë – ajo supozon që të gjithë muslimanët i lexojnë ato tregime gjatë fëmijërisë së vet – meritojnë dënim, për shkak të asaj që ajo sjelljen e muslimanëve e sheh si sjellje dhunuese. Përkatësisht, ky libër ekspozon “mesazhe sublime” për muslimanët i motivojnë përtortura dhe vrasje të të krishterëve!

Sic sqaron Nada Todorov, këto tregime “negativisht ndikojnë në sjelljen e fëmijëve dhe të rriturve në vendet me ndikim të theksuar islamik.”

Ky ndikim nga tregimet “*Njëmijë e një netë*” lehtë mund të tregohet: “Pasi që shumica e këtyre tregimeve janë përplot erotikë, është e sigurt që shumë me kujdes lexohen në kohën e pubertetit, prandaj ndikimi i tyre në personalitetin është tërësisht i qartë. Mesazhet mbresin të thurura në vetëdije apo në subkoshiencë. Në shembullin e krimit në hapësirat e Bosnjës dhe Hercegovinës ndikon niveli i personalitetit të vetëdijshëm, subkoshient dhe inkoherent.”<sup>23</sup>

## Muslimanët si tradhtarë

Ana tjetër e tërë ndikimit është përqëndruar mbi kinse tradhtinë e muslimanëve për atë që kanë konvertuar në islam. Orientalistët serbë si edhe nationalistët e tjerë, duke e kyqur hierarkinë e Kishës ortodokse, janë të prirur për ekspozimin e argumenteve të rrepta, të cilat kanë të bëjnë me etnicitetin e papranuar apo inkoshent serbë të muslimanëve boshnjakë si edhe të fqinjve të shumtë të tjerë të tyre. Është e zakonshme që orientalistët serbë insistojnë në atë që muslimanët kanë qenë me

<sup>23</sup> Intervistë me Nada Todorovin, *Vojška*, op. cit., 8 prill 1993, faqe 20.

të vërtetë serbë, të cilët e kanë braktisur fenë e tyre të mëparshme. Në mënyrë tipike, një shkencëtar, Mile Nedeljkoviq, pjesën më të madhe të monografisë së vet nën titullin “*Krst i polumesec (Kryqi dhe gjysmëhëna)*” ia ka kushtuar argumenteve që Bosnja dhe Hercegovina përherë kanë qenë serbe dhe ortodokse dhe sipas kësaj muslimanët janë serbë dezertorë!<sup>24</sup>

Ashtu siç praktikisht vlen për të gjithë popujt e tjerë evropianë, muslimanët e sotëm në Bosnjë dhe Hercegovinë janë përzierje e trënjëve të ndryshme etnike. Ndërkaq, shumica mbisunduese ka prejardhje nga të krishterët lokal apo prej popullatës bogomile të krishtere, e cila ka konvertuar me etapa në Islam gjatë tre shekujve, duke e mbajtur gjuhën e tyre të mëparshme.

Sipas kësaj, muslimanët assesi nuk janë bashkësi e huaj, përkundër zakonit serb që t'i quajnë me termin pezhorativ (urrejtës) “Turq” apo “poturë”. Përkundër argumenteve të motivuara politike të nationalistëve të shumtë serbë, që muslimanët e sotëm janë me prejardhje serbe, megjithatë ekzistojnë pak të dhëna se një numër i konsiderueshëm serbësh janë konvertuar në Islam, menjëse ata e kanë populluar Bosnjën dhe Hercegovinën pas pushtimeve otomane.<sup>25</sup>

---

<sup>24</sup> Mile Nedeljković, *Krst i polumesec [Kryqi dhe gjysmëhëna]*, Politika, Beograd, 1993.

<sup>25</sup> Vështrimi kushtuar bashkësisë muslimane boshnjake, historisë dhe etnografsë së tyre, mund të shihet në veprën e Vatro Murvar, *Nation and Religion in Central Europe and the western Balkans: the Muslims in Bosnia, Herzegovina and Sandžak: A Sociological Analysis* [Kombi dhe religionet në Evropën qëndrore dhe në Ballkanin perëndimor – Muslimanët në Bosne, Hercegovinë dhe Sanxhak – Analiza sociale], Brookfield, Wisconsin: University of Wisconsin, 1989. Disa serb në Serbi gjatë shumë shekujve janë konvertuar në Islam, por ata ose kanë qenë të vrarë ose të detyruar që ta lënë islamin, ose madje kanë ikur nga Bosnja dhe vendet e tjera të perandorisë Osmane gjatë kohës kur serbët i pastronin territorët, çka ishte pjesë e praktikës së krijimit të shtetit të tyre në shekullin XIX.

Paradoksal është pohimi që muslimanët janë serbë të dikurshëm kapricioz dhe të padëgjueshëm, ta lëmë në një anë bazën e dyshimtë të pohimit të tillë nga pikëpamja shkencore – që shërben si municion shtesë për kampanjën antiislame.

Miroljub Jevtiqi, për shembull, vë akcent në shpjegimin mbi muslimanët boshnjakë si tradhtarë: “Ata të cilët e kanë pranuar islamin, kanë tradhtuar idenë e Bosnjës... i kanë pranuar pushtuesit de fakto, si vëllezërit e vet dhe krimet e tyre për të vetat. Do të thotë edhe duart e tyre janë të lyera me gjakun e të parëve të tyre – të popullatës së atëhershme jomuslimane.”

Me këthimin në Islam, muslimanët e rrënuan Bosnjën e krishtere “dhe kontribuan që Osmanlijtë të sundojnë në Bosnjën e krishtere.”<sup>26</sup>

Çfarëdo qoftë ajo, që mund të shfrytëzohej, që të kritikoheshin muslimanët, ishte e vënë në lojë, madje edhe akuza që ata e kanë tradhtuar “Stjepan Tomasheviqin, mbretin e fundit katolik të Bosnjës”, për të cilin vështirë se do të ishte interesuar ndonjëri nga nacionalistët serbë në kohët e zakonshme. Duke sulmuar interesin e përtërirë të muslimanëve të Bosnjës dhe Hercegovinës për Islam, për aktivitetin fetar dhe besimin në vitet e t-tëdhjeta të këtij shekulli, Jevtiqi pohon, “Pra, asnje vend normal nuk do të kishte duruar që një bashkësi fetare praktikisht ta propagandojë dhe ta popullarizojë okupatorin, i cili këtë vend e ka mbështjellur me të zeza!”<sup>27</sup>

---

<sup>26</sup> Miroljub Jevtić, *Duga*, op. cit., 9-22 dhjetor 1989, faqe 22.

<sup>27</sup> Po aty, faqe 23.

## Izolimi i muslimanëve

Gjithashtu, orientalistët serbë synojnë izolimin e muslimanëve nga fqinjtë e tyre. Si duket këtyre orientalistëve sidomos u pengojnë lidhjet e forta në mes muslimanëve dhe kroatëve, prandaj janë përpjekur që këtu, në vend të marrëdhënieve të mira, të mbjellin farën e përqarjes.

Jevtiqi, për shembull, lidhjet e këtilla i akuzon si “lidhje martesore nga interes” dhe shpjegon që kjo është bërë me paramendim, veçanërisht kundër interesave serbë. Përveç kësaj, Jevtiqi, përpiqet që ta paralajmërojë Kroacinë që kjo “martesë nga interes”, gjithashtu, është kundër interesave të Kroacisë, sepse nataliteti musliman do të jetë aq i lartë saqë ata madje do të mund “ta gëlltitnin” Kroacinë.<sup>28</sup> Edhe, marrëdhëniet e mira në mes Kishës katolike dhe Islamit, gjithashtu iritojnë orientalistët dhe i përkasin diçkaje që nuk i përgjigjet llogarive të tyre.

Kështu, kur partia e re Demokratike e Kosovës e zgjodhi në fund të vitit 1993 si kryetar të vetin një musliman, Jevtiqi këtë e karakterizoi si “farsë” dhe e shënoi me nënverësim që “kjo me të vërtetë mund të bëhet vetëm në Kosovë!”<sup>29</sup>

---

<sup>28</sup> Intervistë me Miroljub Jevtiqin (intervistuar nga Jasmina Babic) *Vera i politika* [Feja dhe politika], *Stav* (Novi Sad, Vojvodinë, Serbi), 1 maj 1992, faqe 37.

<sup>29</sup> Miroljub Jevtić, *Europske novosti*, op. cit., 22 dhjetor 1993, faqe 2.

## Bashkësia e delegjituuar

Orientalistët serbë kanë kontribuar, me plotëkuptimin e fjalës, për delegitimimin dhe vetëekzistimin e muslimanëve si bashkësi dhe, duke i çħumanizuar, gjithashtu, i delegitimuan muslimanët si qenie individuale njerëzore.

Kategorizimi i këtillë negativ, e zakonshme në të drejtuarit e orientalistëve serbë, mund të ketë efekt devastiv përmes çħumanizimit të grupit të shënuar si cak dhe mund të kontribuojë në cytjen e vrasjes së tyre si anëtarë të një grupacioni të padiferencuar, grupacionit të njerëzve të padëshiruar! Pikërisht siç e përmend shpesh edhe Herbert C. Kelman (Herbert S. Kelman), ekspert për gjenocid:

“Masakrat e sankcionuara bëhen të mundura atëherë kur arrijnë deri te masa e asgjësimit të qenieve njerëzore të afërt me identitetin dhe bashkësinë. Domethënë, kur një grup njerëzish definohet tërësisht me kategorinë të cilës i takon dhe kur kjo kategori tërësisht përjashtohet nga bashkësia dhe familja njerëzore, atëherë pengesat morale që ky grupacion të mos vritet më lehtë tejkalo-hen.”<sup>30</sup>

---

<sup>30</sup> Herbert C. Kelman, *Violence without moral restraint: Reflections on the dehumanization of victims and victimizers* [Dhunë pa pengesa morale – Refleksione të dehumanizmit të viktimës dhe autorit], *The Journal of Social Issues*, vël. 29, nr. 4 (1973), faqe 49.



# Muslimanët kërcënues ekzistencial për çdo gjë

## Kërcenim i përhershëm

Element kyç i mesazhit qëllimkeq të orientalistëve serbë, gjithashtu, ishte ai që muslimanët paraqesin kërcenim të paevitueshëm dhe vdekjeprurës. Pastaj, këta shkencëtarë shkonin pas asaj që t'i përgatisnin bashkëvendasit dhe bashkëkombësit e vet për këtë rrezikshmëri potenciale duke i sqaruar dhe sugjeruar masat politike për parandalimin kinse të komplateve muslimane. Shumë para agjitimeve luftarake në ish Jugosllavi, Jevtiqi (aktivistik) promovonte idenë mbi atë se si Islami “është rreziku më i madh për Jugosllavinë, më i madh se rreziku i supozuar nga – marrëdhëniet serbo-kroate.”<sup>31</sup>

Aleksandër Popoviq, posaçërisht, besonte që misioni i tij ishte që të paralajmëronte rrezikun nga aktiviteti i shtuar i muslimanëve në Jugosllavi, siç janë ndërtimi i xhamive të reja dhe shkollave fetare, pastaj i ka akuzuar muslimanët për përhapjen e “falsifikimeve brutale...

---

<sup>31</sup> Intervistë me Miroslav Jevtiqin (intervistuar nga Slavoljub Kaçareviq), *Islam bez maske* [Islami pa maskë], *Intervju* (Bograd), 15 1989, faqe 11. *Intervju* është një periodik nacional që favorizon qeverine e Serbisë.

thashethemeve të ndryshme dhe lajmeve të rrejshme” nëpër vende të jashtme mbi kushtet e jetës së vet.<sup>32</sup>

Edhe pse muslimanët kinse janë armiqësish të disponuar ndaj Perëndimit, qëllimi i tyre special është Serbia. “Fare mirë dihet” - sipas Jevtiqit – “që Serbia me luftën e vet e ka çliruar pjesën tonë të Ballkanit nga Hali-fati, prandaj nuk është për t'u çuditur se te përkatësit fundamentalist të fesë Islame kjo serbofobi është shumë e shprehur.”<sup>33</sup>

Megjithëqë të gjithë muslimanët në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk janë besimtarë servilë (duke i përfshirë të shumtit që ishin anëtarë të Partisë Komuniste) orientalistët serbë ishin të detyruar që ta zgjeronin definicionin e fundamentalizmit, që ky të mbulonte një region të gjerrë. Me përhapjen e termit fundamentalizëm, orientalistët serbë, çfarëdo aktiviteti musliman mund ta treshtonin në atë rubrikë! Jevtiqi, për shembull, flet mbi “fundamentalizmin sekular Islamik” dhe “Islamin komunist” që kështu ta përfshinte secilin dhe çdokend që në çfarëdo mënyre është musliman, e që ta bënin cak valid të qortimit!<sup>34</sup>

Gjatë periudhës paraluftarake, me siguri, bile pjesërisht i shtyrë nga ana e qarqeve zyrtare serbe, i është dhënë punës që ta ngarkonte pushtetin komunist i cili ende sundonte në Bosnjë dhe Hercegovinë, me akuza që kinse nuk janë duke e parë këtë fenomen ashtu siç është duke e parë ai. Në të vërtetë, Jevtiqi ka vlerësuar madje që edhe muslimanët të cilët nuk janë duke e praktikuar Islamin kinse janë duke punuar pa vetëdije në dobi të xhihadit dhe shumë gjëra të tjera, përfundon Jevtiqi: “Çka është më e dhembshme, protagonistët e politikës

<sup>32</sup> Aleksandar Popović, *Jugoslovenski muslimani* [Muslimanët jugosllav], op. cit. faqe 51.

<sup>33</sup> Miroljub Jevtić, *Duga*, op. cit. 9-22 dhjetor 1989, faqe 23.

<sup>34</sup> Po aty, faqe 20 dhe 22.

së këtillë më së shpeshti nuk janë formalisht besimtarë, por shumë shpesh janë funskionarë të lartë (komunist) të pushtetit.”<sup>35</sup> Përkundër faktit që nuk ka argumente që një fenomen i tillë ekziston jashtë rregullave të tij, megjithatë, Jevtiqi pohon, se kjo është dukuri më e rrezikshme e fundamentalizmit Islamik... laik, për atë pse esenca e tij është e fshehur, prandaj ajo lehtë depërtton mbi skenën shoqërore.”<sup>36</sup>

Në masë të madhe, kinse vetë esenca e Islamit është komentuar si e pandryshuar, si abstrakcion i padiferencuar, në vete dhe vetvetiu paraqet kërcënëm. Pohohet që armiqësia ndaj serbëve, kulturës perëndimore dhe krishterizmit janë programuar që më parë me kulturën, historinë dhe religionin Islam.

Orientalistët e sotëm serb, kur është në pyetje Islami, shpesh e shohin si stërvadhimin e të kaluarës, ndërsa, botkuptimi i tillë bazohet mbi të lexuarit tendencioz të Kur'anit nga ata dhe aplikimin linear të historisë së hershme Islame në shoqërinë e sotme. Shpjegimi i Kur'anit nga ata, veçanërisht është marrë shpesh si argument i agresivitetit musliman dhe argument i antipatisë ndaj të gjithë jomuslimanëve.

Për shembull, kur kryetari i partisë komuniste të Bosnjës dhe Hercegovinës, Nijaz Durakoviqi në vitin 1989 e vënte në dukje dhe e promovonte atë që e konsideronte traditë tolerancën dhe koekzistencën boshnjake me fetë dhe kulturat e ndryshme, Jevtiqi menjëherë ia kishte kthyer: “Mbi çfarë tolerance mund të flitet kur Islami arrin me shpata, majat e të cilave bartin kokën e mbretit të fundit boshnjak, Stjepan Tomasheviqit?”

<sup>35</sup> Intervistë me Jevtiqin, *Interju*, op. cit., 15 shtator 1989, faqe 12.

<sup>36</sup> Miroslav Jevtić, *Zašto Nijaz Durakovit ne vidi islamski fundamentalizam [Pse Nijaz Durakoviqi nuk e sheh fundamentalizmin islamik]*, *Interju*, 8 nëntor 1989, faqe 52.

Duke pohuar se trashëgimia otomane nuk ka qenë trashëgimi e tolerancës, por robërim, Jevtiqi pyet: “Atëherë, për çfarë tolerance është fjala? Vallë, a mund të flitet ndryshe mbi tolerancën fetare në Perandorinë Osmane të themeluar mbi islamin përveç në mënyrën në të cilën trajtohet qëndrimi i bariut ndaj kopesë së vet, të cilën e ushqen që më vonë të ketë më tepër mish?”<sup>37</sup>

Sipas Jevtiqit, Islami sipas natyrës së vet, kinse, “e përjashton çdo botëkuptim tjetër në botë dhe për vetën e vet kërkon hapësirë komplate. Prandaj, ai sot është i treguar përmes gjithë shoqëritë bashkëkohore.”<sup>38</sup> Siç shtron Jevtiqi, “Islami është kundër çdo komunikimi të barabartë, tolerancës, dialogut dhe (barazisë) bashkimit, dhe në të vërtetë, Kur’ani dhe Sheriati kinse e lejojnë asnjësimin e njerëzve të feve tjera.”<sup>39</sup> Jevtiqi, jo vetëm që i akuzon përmes shkatërrimin e kishave që i takojnë religjioneve të tjera, por “ata jo vetëm që e bëjnë atë, por atë e kanë obligim fetar.”<sup>40</sup> Më 1993, në konferencën e cila ishte e fokusuar ironikisht mbi tolerancën religjioze, Tanaskoviqi, duke e bazuar mendimin e vet mbi interpretimin e teksteve të mëparshme Islamike, pohonte, që sipas Islamit “paqja e përhershme me heterodoksët është e pamundur.” Tanaskoviqi shtron, që “Lufta Islamike e kufizon realizimin e tolerancës në Islam”.<sup>41</sup> Me të vërtetë, nga dëshira që ta lidh të kaluarën me të tashmen në një portret statik, Jevtiqi i akuzon muslimanët vendorë

<sup>37</sup> Miroljub Jevtić, *Intervju*, op. cit., 24 nëntor 1989, faqe 53.

<sup>38</sup> Po aty, faqe 21.

<sup>39</sup> Po aty, faqe 20.

<sup>40</sup> Miroljub Jevtić, cituar në rubrikën “Ljudi i vreme [Njerëzit dhe kohë]”, *Vreme*, 24 maj 1993, faqe 54.

<sup>41</sup> Raportuar nga Andjelika Cvijić, *Ekumenizam – Problem epoke* [Ekumenizmi – Problem epokal], *Spona* (Frankfurt, Gjermani), 2 dhjetor 1993, faqe 14.

që ata janë “bartësit e gjenocidit” që nga kohërat e mesjetës e deri më sot.<sup>42</sup>

## Komploti i muslimanëve kundër Serbisë dhe Perëndimit

Përveç kësaj, këta orientalistë serbë, tani gjatë viteve të tetëdhjeta të këtij shekulli, pohonin që janë duke e parë komplotin me vetëdije dhe sistematik për nënshtimin dhe shkatërrimin e Serbisë dhe ortodoksizmit serb. Janë përpjekje të dukshme për ta fituar simpatinë e Perëndimit dhe përkrahjen nga kjo anë, por me siguri që serbëve t'u ofrojnë ndjenjën e përkrahjes altruiste dhe misionit të ndershëm në dobi të botës së gjerë. Kërcënimi lokal Islamik, shpesh është prezentuar si hyrje në pushtimin e Evropës dhe shkatërrimine e civilizimit Perëndimor në tërsi.

Islami është përshkruar si fe monolite, agresive dhe si bashkësi e cila është e njëjtë në tërë botën, kinse, vepron sipas marrëveshjes sekrete dhe komplotit kundër Perëndimit, e veçanërisht kundër serbëve. Fajtorët nga vendet e jashtme nga forcat Islame të paemërtuara e deri te faktorët e veçantë, sikurse që është Arabia Saudite, janë duke i ndihmuar dhe duke i nxitur muslimanët lokalë. Taktika do të mund të ishte e ashpër dhe violente, ndërsa përherë shkaktarë është fokusimi i xihadit – ose joviolencës, siç është koordinuar vendimi mbi vazhdimin e natalitetit të lartë ose mbi ndërtimin e xhamive të reja. Për shembull, Darko Tanaskoviqi deklaron se është duke e vërejtur “xihadin ekonomik, diplomatik e

<sup>42</sup> Miroljub Jevtić, *Duga*, op. cit., 9-22 dhjetor, 1989, faqe 19.

në veçanti xhihadin demografik”, i cili për qëllim ka edhe Ballkanin edhe Evropën perëndimore.<sup>43</sup>

Gjithashtu, sipas Jevtiqit, “qëllimi i Arabisë Saudite është që ta fitojë ish-Bosnjë dhe Hercegovinën si rrugë hyrëse në Evropë” dhe precizon që, menjëherë ishte e qartë edhe për atë që di fare pak për islamin që vendet muhamedane do ta shfrytëzojnë ekzistimin e muslimanëve tek ne si kolonë e pestë.<sup>44</sup>

Shikuar praktikisht, orientalistët serbë, përpiken që t'i lidhin muslimanët e Bosnjës dhe Hercegovinës me njëfarë Islami të padiferencuar e jo homogen nëpër mbarë botën. Ata në një vend i vënë të gjitha konfliktet ku janë involuar muslimanët, në qoftë se kemi të bëjmë me Filipinet, Azerbejxhanin apo Kashmirin, dhe theksojnë që kjo dukuri është çdokund identike, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina është vetëm një pjesë perbërëse e saj. Kështu është racionalizuar lehtë politika (e gjenocidit kundër bosnjakëve) përkundër violencës që qëndrimi i tillë e paraqet kundër principeve intelektuale dhe etike. Kështu, Jevtiqi vazhdon ta prezentojë Alija Izetbegoviqin, si dikë që fare nuk dallohet nga udhëheqësit e lëvizjeve më ekstreme në botë, duke pohuar që politika e tij “pa kurrfarë dyshimi paraqet formën më radikale të fundamentalizmit Islamik... duke qenë se të gjitha ato që është duke i folur ai në programin e vet politik, nuk dallohen me asgjë nga aksionet që i ka ndërmarrë imam Homeini i ndjerë në Iran dhe as nuk dallohet nga ajo çka është duke ndërmarrë Fronti Islamik i Shpëtimit në Algjeri.”

---

<sup>43</sup> Intervistë me Tanaskoviqin, *Vojška*, op. cit., 23 shtator 1993, faqe 9.

<sup>44</sup> Miroljub Jevtić, *Igra za saveznike* [Loja për aleatët], *Vечерње новости*, 5 gusht 1993, në *Foreign Broadcast Information Service – FBIS, Eastern Europe – EE*, 93-152, 10 gusht 1993, faqe 53 dhe Miroljub Jevtić, *(Ne)Svrstani uz Alaba* [I (pa) Rreshtuar përkrah Allahut], *Srpska strarnost*, 11 qershor 1994, faqe 8.

Përveç kësaj, Jevtiqi konsideron që Alia Izetbegoviqi, në të vërtetë nuk e dëshiron shtetin e pavarur të Bosnjës dhe Hercegovinës, përveç si stadium për të arritur deri te shteti univerzal Islamik. “Të gjitha këto me tërbim i thotë Jevtiqi dhe tregon që nga vesternizimi i pritur i muslimanëve (bosnjakë) vështirë që do të ketë diç.”<sup>45</sup>

Pikërisht, Jevtiqi ishte ai, i cili në librin e vet kushtuar xhihadit, ka dhënë elaboratin e tërësishëm të këtij fenomeni. Ai konsideron që vetë nocioni i xhihadit është pjesë e papërballuar e Islamit, diç që është prezente dhe e pandryshuar përherë dhe çdokund. Madje, ende derisa ekzistonte Jugosllavia, në atë kohë, nuk ka pasur akte të dhunës si të tillë. Përkundër të gjitha këtyre, Jevtiqi po hon që është duke i vërejtur format më të qeta, por aspak më të parrezikshme të xhihadit të cilat kinse janë në skenë, duke pranuar, kinse udhëzimet nga “institucionet botërore Islamike... të cilat përmes mjeteve të mëdha materiale përpiken që ta pushtojnë botën.” Muslimanët jugosllavë, po hon Jevtiqi, tanjani janë duke u shërbyer me taktika të tillë dinake sikur që janë: “nataliteti i lartë, ndërtimi i xhamive, shtypja e popullatës jomuslimane.” Jevtiqi ka vlerësuar që: “në bazë të deklaratave detale shihet që kjo tendencë ka sukses me më efikasitet dhe pa shumë zhurmë ta realizojë qëllimin e vet.” Jevtiqi, megjithatë, paralajmëron që kjo paraqet kërcënim më serioz për Jugosllavinë.”<sup>46</sup>

Te çdo musliman qëndron kinse plani i menduar që Serbia të dërmohet. Sipas Jevtiqit, pakica muslimane në Serbi shërben si urëmbrojtëse për “Islamizimin komplet të Serbisë.” Për shembull, kur bashkësia muslimane e

<sup>45</sup> Miroljub Jevtić, *Ništa od Zapada* [Asgjë nga perëndimi], *Europske novosti*, 31 mars 1994, faqe 2.

<sup>46</sup> Miroljub Jevtić, *Savremeni džihad kao rat* [Xhijadi bashkëkohor si luftë], Biblioteka Popullore e Serbisë, Beograd 1989, faqe 316-317.

Beogradit, ka kërkuar tokë për varreza më 1990 për anëtarët e vet, Jevtiqi kishte reaguar duke alarmuar. Ai ua kishte tërhequr vërejtjen që “nga toka për të vdekurit, fillon në pushtimin e tokave për të gjallët. Kanë për të kërkuar xhami – çka është plotësisht legitime, por pas kësaj kanë për të kërkuar vend rrëth xhamive, për t'i vendosur muslimanët. Dhe atëherë, deri te shpërngulja e jomuslimanëve së pari vullnetarisht, e pastaj nën presion, nuk është fare larg... Plani është, të vendoset popullata muslimane në ato vende, të shtohet nataliteti dhe gradualisht të arrihet përparësia numerike.” Për argument të vet kryesor, ai drejton gishtin mbi një leksion objektiv, në të vërtetë, mbi atë çfarë kishte parë si jetë e trazuar e natës në kuartin Parisian Pigal (Pigalle) pas vendosjes së muslimanëve të Afrikës së veriut. Shikuar në këtë dritë, madje edhe kërkesa për varrezat muslimane është “çështje politike globale.” Serbia, pikërisht tanë është vetëm një pjesë e planit që përsëri të pushtohen territoret e humbura jo vetëm në Ballkan, por gjithashtu pohon Jevtiqi edhe në ishullin Iberian.<sup>47</sup>

Duke i përkthyer vlerësimet e veta të tmerrshme në terme konkrete, Jevtiqi gjatë kohës kur situata politike bëhej e tendosur, paralajmëron pa kurrfarë argumenti real, se ekzistojnë lëvizje të cilat janë duke e përgatitur rikthimin e më se një milion muslimanëve të vendosur në Turqi, pasi që ishin të detyruar ta braktisin Sanxhakun në kohët e hershme. “Çfarë do të bëhej me Serbinë sikur në të vendoseshin njerëz vetëdije nationale turke?” – pyet ai me retorikë dhe shton: “Është më tepër se evidente që ideja e panturqizmit tanë është mishëruar, para

<sup>47</sup> Miroljub Jevtić, *Šta se krije izgroblja: Islam juriša na Srbiju* [Çka fshehet pas varrit – Islami vërsulet mbi Serbinë], *Ilustrovana Politika* (Beograd), 18 dhjetor 1990, faqe 25. *Ilustrovana Politika* është nën kontrollin e pushtetit Serb.

së gjithash, në krijimin e “Turqisë së madhe” e cila do t’i përfshinte të gjitha pronat e Perandorisë Osmane. Kjo tregon, që Turqia është armik i madh dhe i fshehur i tërë popullsisë krishtere të Ballkanit. Më sakt, të gjitha rreziqet që i kanosen janë më pak të rrezikshme sesa rreziku panturk.”<sup>48</sup>

Shkenctarët e rrejshmëm serbë i kanë shtuar paralajmërimet e veta mbi kinse rrezikun islamik së bashku me kampanjën e pëgjithshme propaganduese, të cilën e ka ndërmarrë pushteti serb kur Bosnja dhe Hercegovina ishte sulmuar në vitin 1992, duke mbithesuar rrezikun nga vendosja e shtetit musliman. Sipas Jevtiqit, rreziku tani është edhe më i madh, e ai nga ana e muslimanëve merr formën e “planit të errët” për të vendosur shtetin mesjetar.<sup>49</sup>

Duke zgjeruar shumë më tepër rrjetin, Vojin Dabiç, profesor i historisë bashkëkohore në Universitetin e Beogradit, jo vetëm që muslimanët e Bosnjës dhe Hercegovinës, por gjithashtu edhe muslimanët e Sanxhakut, Shqiptarët në Kosovë si edhe pakicat turke në Bullgari dhe Greqi, i konsideron “rrezik” për Evropën, sepse Islami nuk mund ta pranojë që religioni të jetë i ndarë nga shteti. Te ta ekziston simbiozë e çuditshme e fesë dhe shtetit, fesë dhe kombit.”<sup>50</sup>

Ndërkaq, nën shtetin “islamik”, të cilin këta orientalistë e imagjinojnë, nuk mendohet assesi për shtetin e udhëhequr nga pushteti i inspiruar me doktrinat islame e

<sup>48</sup> Miroljub Jevtić, *Turci (opet) žele Srbiju* [Turqit (përsëri) e dëshirojnë Serbinë], *Srpska reč* (botohet nga partia çetnike, Lëvizja Serbe e ripërtëritjes) (Beograd), 19 gusht 1991, faqe 64, dhe Miroljub Jevtić, *Panturizam i njegova uloga u jugoslovenskoj krizi* [Panturqizmi dhe roli i tij në krizën jugosllave], *Vojno Delo* (Beograd), janar-prill 1994, faqe 19.

<sup>49</sup> Lajmet e TV Beogradit, 6 dhjetor 1992.

<sup>50</sup> Intervistë me Vojin Dobiç, *Polimesec muči zapad* [Gjysëmhëna e shtynë perëndimin], *Evropske novosti*, 14 prill 1993, faqe 18.

as nuk mendohet për shtetin e udhëhequr nga islamistët, ku varietetet e ndryshueshme varen nga rrethanat specifike, por thjesht mendohet mbi shtetin në të cilin shumica e popullsisë do të jetë muslimane, siç është në Shqipërinë Veriore, e cila konsiderohet konstante në këtë pikëpamje.

Sipas kësaj, të jesh muslimanë thjeshtë, pa pasur parasysh orientimin politik, është diç që vetveti nuk është e lejuar, kriter i mjaftuar për akuza dhe arsyetim për mbytje.

## Misioni paralajmëruar

Sipas këtyre orientalistëve, kërcënimi musliman, siç është përmendur, shkon larg kufijve të Serbisë, prandaj këta orientalistë konsideronin, gjithashtu, si mision të vetin, për ta paralajmëruar Perëndimin e përgjumur. Për Jevtiqin, rreziku qëndron në atë se pse “planifikuesit islamikë” të ndihmuar nga bashkëmendimtarët vendas, kanë për detyrë islamizimin e tërë Serbisë, i cili është vetëm hap i parë për depërtimin në Evropë.<sup>51</sup>

Shkencëtarët e tjerë janë përqëndruar në problemin e muslimanëve në Serbi që ta përshkruajnë si pjesë e kërcënimit të gjerë të drejtuar kundër tërë Perëndimit. Dabiqi, për shembull, e drejton gishtin mbi bashkësitetë muslimane në Britaninë e Madhe, në Itali dhe në Francë, në vendet të cilat ai konsideron se janë të “vërshuara” dhe u zihet fryma nga muslimanët dhe përpinqet që ta fitojë simpatinë e vendeve perëndimore, duke pasur parasysh

<sup>51</sup> Miroljub Jevtić, *Srpska regj*, op. cit., 19 gusht 1991 faqe 65. Në të vërtetë, Jevtiqi thekson që “Ne shpresojmë që e tërë kjo është e qartë për njerëzit më të lartë të pushtetit në këtë vend”.

që Serbia, pohon ai, vetëm tenton që të përballet me të njëjtin problem të cilin e kanë edhe ata.<sup>52</sup>

Orientalistët serbë e kanë huazuar autoritetin e vet akademik që t'i mbështesin argumentet e tillë antiislamike jasht Serbisë, që ta bindin opinionin publik për arsyeshmërinë e politikës serbe. Kështu Tanaskoviqi, tipikisht, i paralajmëron shikuesit amerikanë të lajmeve televizive që vendet islame të cilat e ndihmojnë Bosnën “kanë qëllime afatgjate..., jo aq për t'i ndihmuar muslimanët e Bosnës, sa për ta organizuar një vendqëndrim në Evropë për aktivitetet e veta të mëtutjeshme.”<sup>53</sup>

Si pjesë e këtij tentimi që në shtetet e jashtme ta përfitonin simpatinë për politikën antiislame, taktika kyçë ishte të bind publikun e huaj që kryetari boshnjak Alija Izetbegoviq është ekstremist jasht çdo kufiri, njeri të cilit Perëndimi nuk duhet t'i besojë dhe të cilin nuk duhet përkrahur. Për shembull, gjatë përpjekjeve që Shtetet e Bashkuara të ndërprenin ndihmën që i jepej zonës së siguruar të Kombeve të Bashkuara në Gorazhdë, në Bosnjën perëndimore, kur forcat serbe e kishin sulmuar në prill të vitit 1994, Jevtiqi pohonte që, partia fundamentaliste e Alija Izetbegoviqit me siguri nuk është mik i interesave vitale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Njerëzit rreth Clintonit janë të vetëdijshëm që ideali i Alisë është në Iran dhe në Arabinë Saudite, e jo në Diznilend (Disneyland). Kjo na shpie të pyesim: “a mund të jetë interes i SHBA-ve që për atë shkak të vdesin të rinjtë amerikanë dhe të bien aeroplanët?” duke e përkrahur atë.<sup>54</sup>

Orientalistët serbë synonin që Perëndimi tërësisht ta refuzojë islamizmin, që argumentet e tyre t'i marrin me

<sup>52</sup> Intervistë me Dabiqin, *Evropske novosti*, op. cit, 14 prill 1993, faqe 18.

<sup>53</sup> National Broadcast Corporation – NBC Nightly News, 26 tetor 1992.

<sup>54</sup> Miroslav Jevtić, *Stop za bombe* [Stop për bomba], *Evropske novosti*, 21 prill 1994, faqe 2.

seriozitet qoftë me frustracion apo konfuzion. Shpesh pritnin për sqarime ekscentrike që ta argumentonin këtë mungesë të simpatisë për politikën serbe antiislame.

Për shembull, Tanaskoviqi u zemërua kur ministri i atëhershëm italian i punëve të jashtme Xhani de Mikelis (Gianni De Michelis), sipas të gjithave ka thënë që islam i në Turqi dhe në Ballkan është mesatar dhe i pranueshëm dhe si i tillë kundërpesha e ndikimit iranian ishte i mirëseardhur. Duke e akuzuar De Mikelisin për "shkallën e voluntarizmit, johistorizmit, madje edhe e naivitetit", Tanaskoviqi ka paralajmëruar që përkundrazi "ky vend i civilizimeve më të vjetra evropiane është bërë një lloj i paradhomës së orientalizuar të 'Evropës së re'". Për Tanaskoviqin, pakësimi i kujdesit evropian për Islamin në Ballkan është "më vështirë të kuptohet dhe të tejkalohet" dhe ai i çorton "delegatët e papërkultur evropianë dhe përkrahësit e tyre të frymëzuar ballkanas."<sup>55</sup>

Ngjashëm me këtë, Jevtiqi i fajëson Shtetet e Bashkuara për përkrahjen e muslimanëve dhe pohon që "Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë të vetëdijshme se janë duke ia bërë varrin vvetvetes."<sup>56</sup> Duke u përpjekur që ta sqarojë përkrahjen e amerikanëve, Jevtiqi përfundon se me të vërtetë Washingtoni (Washington) u shërbën dy fuqive në regjion, Gjermanisë dhe Arabisë Saudite, që ta përfiton përkrahjen e tyre për "kontrollin mbi botën islame".<sup>57</sup> Në këtë kontekst, Gjermania ishte 'bête noire' (dele e zezë) [bajloz] për orientalistët serbë aq sa edhe për intelektualët e tjerë serbë dhe nëpunësit e shtetit, të cilët së bashku tentonin ta kapitalizonin

---

<sup>55</sup> Darko Tanasković, *Izvješće u predstojnju Evrope* [Zbathja në paradhomën e Evropës], *Duga*, 15-28 mars 1992, faqe 37.

<sup>56</sup> Intervistë me Jevtiqin, *Star*, op. cit., 1 maj 1992, faqe 37.

<sup>57</sup> Miroslav Jevtić, *Vesternje novosti*, op. cit., 5 shtator 1993, *Foreign Broadcast Information Service – FBIS, Eastern Europe – EE*, 93-152, 10 shtator 1993, faqe 53.

armiqësinë ndaj të kaluarës gjermane, duke i mobilizuar përkrahjet në vend dhe jashtë vendit për veprimet serbe. Dabiqi, për shembull, në këtë mënyrë e vlerësonte kritikën gjermane të trajtimit të muslimanëve nga serbët. “Që nga ai moment, kur gjermania kuatoi se interes i saj është në Bosnjë, për ta siguruar korridorin për detet jugor, e filloi që të na drejtonte (korrigjonte).”<sup>58</sup> Gazetari e kishte pyetur Dabiqin: “Gjermanët pretendimet e veta i kanë shprehur qartë edhe këtë herë. Kur u ndalua marrshimi në juglindje përmes Serbisë, ata vendosën të niseshin përmes Bosnjës, Sanxhakut dhe Bullgarisë. Vallë a edhe për këtë e akuzojnë Serbinë?” Në këtë pyetje sugjektive Dabiqi ishte përgjigjur me serinë e non sekuitursit: “Kaherë, e tërë politika gjermane shkonte në drejtim të konfrontimit me shtetet serbe. Rrugët çonin përmes Bosnjës. Tani ky do të ishte tentim i sërishtë i aneksimit, pastaj do të vinte destabilizimi i Sanxhakut. Dhe përmes historisë shihet se gjermanët me këmbëngulësi i pamundësonin Serbët të zgjerohen.”<sup>59</sup> Dabiqi, gjithash tu, e racionalizoi mungesën e simpatisë perëndimore duke përfunduar se tani Perëndimi është duke u hakmarrë për përkrahjen që pushteti komunist ia dha OÇP-ës (Organizatës Çlirimtare Palestineze) dhe për lehtësimet që ua ka dhënë grupeve të ndryshme terroriste.<sup>60</sup> Megjithatë, nganjëherë shkencëtarët serbë ishin bile një çik më optimistë duke shpresuar që Perëndimi më në fund do ta shfaq gjykimin mbi situatën serbe. Dabiqi, për shembull, përkundër zhgënjinimit të deritanishëm, është i bindur që, “as Amerika e as Evropa lindore nuk kanë për ta lejuar krijimin e shtetit të ri islamik në zemër të Ballkanit (mjafton vetëm një Shqipëri), sepse shteti i tillë do të

<sup>58</sup> Intervistë me Dabiqin, *Evropske novosti*, op. cit., 14 prill 1993, faqe 18.

<sup>59</sup> Po aty.

<sup>60</sup> Po aty.

ishte bazë e re për përhapjen e terrorizmit dhe për një fushatë edhe më agresive mbi Perëndimin.”<sup>61</sup>

Më tutje, Tanaskoviqi pohonte që evropianët perëndimorë tanë janë duke e vërejtur fenomenin monolit “kërcënimin islamik të përbashkët politik dhe kulturor, për të gjithë ata, qoftë siç thotë ai në Lion (Lyons) në Francë, Bredford (Bradford) në Angli, apo në Sarajevë.”<sup>62</sup>

Në të vërtetë, një punëtor shkencor, Radosllav Stojanoviq, profesor në fakultetin Juridik të universitetit të Beogradit dhe anëtar i këshillit ekzekutiv të njërsë prej partive opozitare, të Partisë Demokratike Serbe, ishte veçanërisht optimist në pikëpamje të afri të interesave serbe dhe perëndimore në lidhje me muslimanët. Ai mendon që prioriteti real i Perëndimit për veprimin në Bosnjë dhe Hercegovinë është ndalimi i “fundamentalizmit islamik”: “Perëndimi më tepër kujdesej që ta pengonte krijimin e shtetit musliman në Bosnjë, sesa ta pengonte krijimin madje edhe të Serbisë së Madhe...një shtet musliman në Ballkan, në Evropë do të mund të bëhej vendqëndrim i fundamentalizmit më ekstrem islamik, ku do të derdheshin paratë e vendeve islamike dhe ky shtet do të mund të bënte çudira në Evropë.” Për këtë, ai është duke vajuar, pse serbët, duke mos e kuptuar këtë, e kanë lëshuar shansin që ta krijojnë madje një zonë më të madhe nën kontrollin serb, kinse bile me lejimin pasiv të Perëndimit. Atij i vie keq pse “mjerisht, pushteti serb as në Bosnjë e as në Serbi nuk është në gjendje ta kuptojë një gjë: që Perëndimi është më i interesuar për të pamundësuar krijimin e shtetit musliman në Bosnjë dhe Hercegovinë sesa për realizimin e planit për krijimin e Serbisë së Madhe.”<sup>63</sup>

<sup>61</sup> Po aty.

<sup>62</sup> Intervistë me Tanaskoviqin, *Vojska*, op. cit., 23 shtator 1993, faqe 9.

<sup>63</sup> Intervistë e Momira Djokoviqit me Radovan Stojanoviqit, *Povratak vrednostima Srbije* [Kthimi i vlerave të Serbisë], *Spona*, 10 qershori 1993, faqe 15.

## **Nga analiza deri te avokatura - arsyetimi i gjenocidit**

Kurrë nuk është shënuar që orientalistët serbë të kenë kritikuar spastrimin etnik kundër muslimanëve, madje as në terminet gjenerale, e veçanërisht nuk i kanë dënuar aspektet specifike të procesit të tillë, si për shembull, kampet e përqëndrimit. Përkundrazi, qëllimi i tyre kryesor ishte mohimi i vetë faktit që është duke ndodhur gjenocidi. Kjo merrte forma të ndryshme; qoftë ajo heshjta, negacioni i hapur të çfarëdo vepre jonjerëzore, duke përfshirë edhe ngarkimin e përgjegjësisë për të gjitha aktrimet mbi muslimanët dhe kështu duke e ndërruar rolin e viktimës me kryesin e veprës, ose madje ofrimi i arsyetimit implicit për të gjitha që i ka goditur muslimanët. Orientalistët serbë vazhduan ta ofrojnë ekspertizën e vet mbi sulmin ndaj muslimanëve në planin intelektual dhe përkrahjen e politikës në pushtet, njësoj siç e bënин këtë më herët në fazën parapërgatitëse.

Ndërkaq, tani, prapa argumeteve të tyre, qëndronin masat e rrepta të cilat me të vërtetë zbatoheshin kundër muslimanëve dhe si të tilla e siguronin sqarimin shkencor dhe arisetimin për krime të luftës, në vend të aromës abstrakte akademike të cilën e kishin më herët.

Libri i Nedeljkoviqit, për shembull, e arsyeton dëbimin e muslimanëve nga Serbia në shekullin nëntëmbëdhjetë (XIX), si mënyrë e çlirimt nga tradhtarët dhe me

eufemizëm përfundon në fund të fundit, sot ai proces është harruar në tërësi, si “bora e shkrirë që moti”. Më tutje, autori, duke u përpjekur që ta arsyetojë atë proces, pohon që “sikurse çdo shtresë përcjellëse rreth okupatorit; prej tyre, u zhdukën me kohën edhe ata banorë të cilët pozitën dhe pasurinë e vet e krijonin mbi eksplorimin dhe kinse plaçkitjen e popullatës së nënshtuar.”<sup>64</sup> Nga ana e vet, Jevtiqi është përpjekur që akuzat për krimet të luftës të kryera nga ana e serbëve t'i shtrembërojë duke e drejtuar ‘non sequitur’ që pikërisht vendet islame janë kundërvajtës të të drejtave të njeriut.<sup>65</sup>

Shkencëtarët e tjerë serbë, inspirimin për qëndrimin ndaj muslimanëve e kërkonin te Petër Njegoshi, klerik dhe sundues ortodoks, antimusliman i Malit të Zi nga shekulli XIX, shkrimet e të cilit lavdërojnë dhe arsyetojnë dëbimin e dhunshëm të muslimanëve në atë vend. Në tubimin shkencor, me rastin e festimit të ditëlindjes së Njegoshit, në vitin 1993, shkencëtarët serbë atë e lavdëronin si “poet i madh dhe filozof humanist.”

Njëri nga ata, Dragutin Vukoviq, duke u thirrë në siç e sheh ai, luftë e përhershme e interesit në mes “Përëndimit dhe Lindjes, (në mes) kryqit dhe gjysmëhënës” ka përfunduar që “ne sot duhet t'i përbahemi qëndrimeve të Njegoshit, sepse ato janë relevante dhe sepse koha nuk i ka vjetëruar... Analogjitetë janë të qarta dhe aplikimi i vlerësimeve të Njegoshit në kohën tonë është i pashmangshëm.”<sup>66</sup>

Me siguri, Jevtiqi ishte më ekstrem në negacionin e çfarëdo mundësie të kompromisit me muslimanët për

<sup>64</sup> M. Nedeljković, *Krst i polumesec* [Kryqi dhe Gjysmëhëna], op. cit., faqe 105.

<sup>65</sup> Miroljub Jevtić, *Samo goli interes* [Vetëm interes i zbrazët], *Evropske novosti*, 1 qërshor 1993, faqe 2.

<sup>66</sup> Cituar në: *Da çovjek bude çovjek* [Që njeriu të jetë njeri], *Spona*, 7 tetor 1993, faqe 22.

shkak të esencës së vet religionit të tyre. “Të gjithë njerëzit qëllimmirë duhet ta kenë të qartë” tregon ai, “që paqe me fundamentalistët islamik nuk ka dhe as nuk do të mund të ketë.” Në përgjithësi është i njohur fakti që islam nuk e pranon koekzistencën e muslimanëve me jomuslimanët në barazi.” Praktikisht, duke folur, duke e lexuar islamin monilit, e ka shtyer që ta propagandojë vazhdimin e zgjidhjes së dhunshme deri te përfundimi i tij logjik, sepse “shpresa për paqe me Alija Izetbegoviqin është vetëm iluzion.” “Prandaj, të gjitha negociatat me të janë vetëm humbje kohe dhe pezullim i qërimit të hesapeve, të cilat ai i imponon.”<sup>67</sup>

---

<sup>67</sup> Jevtić, *Evropske norosti*, op. cit., 28 dhjetor 1993, faqe 4.



## Konluzionet dhe implikacionet

### Roli dhe përgjegjësia e orientalistëve

Natyrisht, është e pamundur të caktohet se në çfarë mase orientalistët serbë ishin të sinqertë në bindjet e tyre, përkatësisht në çfarë mase ishin të udhëhequr me motivacione të tjera: patriotizmin, përfitimin material apo dëshirën për popullaritet. Pa i pasur parasysh qëllimet e tyre, është për t'u habitur se në çfarë mase qëndron njëanshmëria e këtyre pseudoshkencëtarëve, jo vetëm e hapët, por në ndonjë moment anakronike, e rreptë dhe raciste dhe sikur i mungon madje imagjinimi i subtilitetit të orientalistëve të mëhershëm evropianë. Siç vëren Saidi, ky lloj i orientalizmit nuk është praktikim objektiv i punimit shkencor dhe më pak ndërrimi me popullatën, e cila hulumtohet, por më me dëshirë dominimi i pakompromis i udhëhequr me motivacione politike. Siç thotë ai: "Kjo tani, jam duke pohuar, nuk është as shkencë, as dituri e as mirëkuptim, kjo është të shprehurit e forcës dhe vërtetimi i autoritetit absolut. Kjo përbëhet nga racizmi dhe për publikun e përgatitur më parë është bërë e pranuar në mënyrë komparative që t'i dëgjojë të vërtetat e tij muskuloze."<sup>68</sup>

---

<sup>68</sup> Edward W. Said, *Orientalism reconsidered* [Përsëri mbi Orientalizmin], *Race and Class*, dimër 1985, faqe 8.

Me të vërtetë, orientalistët përbëjnë vetëm një grup në krahasim me faktorët e tjerë në skenën kulturore dhe politike serbe dhe ata janë vetëm një pjesë e përpjekjes së gjerë, e cila i përfshin masat e gjera të klasës politike serbe, e jo vetëm disa vagabondë të zakonshëm të izoluar. Kjo përpjekje i përfshin figurat udhëheqëse të politikës serbe, intelektualët, gazetarët dhe kishën ortodokse serbe. Ndërkaq, përkundër numrit të tyre të paktë, orientalistët serbë zënë një vend të rëndësishëm në procesin politik, sepse, si profesionalist, atë që ata mund të ofrojnë është njohja shkencore e islamit. Me keqpërdorimin e shkencës dhe përzierjes së saj me retorikën politike, ata e kanë definuar islamin dhe bashkësinë muslimane lokale në mënyrë që kanë kontribuar dukshëm në intensifikimin e armiqësisë ndaj muslimanëve dhe në anën tjetër gjenocidin e kanë bërë zgjidhje të pranueshme, për atë që kanë ndihmuar që ta bindin publikun serbë “kërcënim musliman”.

Realisht, në këtë rast, ndikimi i orientalistëve serbë mbi politikën nuk mund t'u lihet publikimeve të tyre shkencore të cilat me siguri kanë pasur rrëth të kufizuar lexuesish. Para së gjithash, këta ishin eksponimi i gjerë i medias që e gjemonin në Serbi, konsultimi i tyre direkt me nëpunësit e pushtetit dhe pjesëmarrja e tyre në kampanjat propaganduese zyrtare jashtë vendit, të cilat ua mundësonin të laujnë rol të rëndësishëm.

Deri te zgjedhjet e shumëfishata në nëntor të vitit 1990 në Bosnjë dhe Hercegovinë, kjo republikë ishte nën kontrollin e pushtetit të fortë komunist, çka e pamundësonte reagimin publik antiislam të orientalistëve serb. Si rezultat, duke filluar që nga tetëdhjetat, orientalistët serbë, në çdo pikëpamje me rëndësi në Serbi, kishin liri të plotë për ta paraqitur cilindo argument, pa pasur parasysh se sa i pabazë është ai, i ndërë apo fyes, pa

u frikësuar nga dënim i efektiv politik. Është fakt që asnjë institucion i rëndësishëm serb, siç është kisha ortodokse serbe apo partitë opozitare, nuk kanë marrë qëndrim kritik ndaj sulmeve antiislamike, por, gjithsesi, ua kanë mundësuar veprimin orientalistëve serbë për përhapjen e mesazhit të urrejtjes. Në të vërtetë, kontributi i orientalistëve e plotësonte dhe e forconte rastin, të cilin e kanë vënë në veprim segmentet e tjera të klasës politike serbe, të cilët shpesh mbështeteshin mbi argumentet e tyre, qofshin ato fetare apo gjeostrategjike, varësisht nga rasti.

Eksperiencia nga Serbia, përgjithësisht mund të ilustrojë se ku do të ishte ndikimi më i madh i orientalistëve. Në të shumtën e rasteve të zhvillimit të masave politike, ndikimi i orientalistëve nuk duhet të jetë në përcaktimin real të politikës, sepse kjo është domeni i atyre që sjellin vendime politike. Masat politike zakonisht formohen dhe implemetohen si përgjigje e interesave konkrete politike. Ndërkaq, ajo ku orientalistët luajnë rol të rëndësishëm është shtimi i efikasitetit të një partie politike, duke e bërë atë të pranueshme brenda dhe jashtë shtetit, përmes sigurimit, arsyetimit dhe respektabilitetit pompoz. Sidoqoftë, orientalistët kanë ndikim të caktuar në sajë të diturisë së tyre profesionale dhe shqyrtimeve të cilët ua mundësojnë që të tregojnë mbi lëshimet e politikës së caktuar dhe sugjerojnë alternativa. Si rezultat, ata janë në gjendje të modifikojnë, madje të ofrojnë ndërrimin e politikës kur janë të disponuar për artikulimin e argumenteve dhe për ndërprerjen e përkrahjes së vet atyre që konsiderojnë që janë duke udhëhequr me principe të gabuara.

Në rastin e Serbisë, është më se e vërtetë që spastrimi etnik do të kishte ndodhur edhe pa përkrahjen e orientalistëve. Ndërkaq, opozita e vendosur e këtij procesi nga ana e këtyre shkencëtarëve mund t'uam merrte një pjesë të konsiderueshme të legjitimitetit aktorëve të krimít.

Përkundrazi, orientalistët u bënë parti aktive e spastrimit etnik. Në vend të shfrytëzimit të ekspertizës së tyre të njojur në kundërshtimin e procesit të viktinizimit, ata autorëve të gjenocidit ua kanë vënë në disponim kredibilitetin e tyre të jashtëzakonshëm, që ta ndanin, ta izolonin dhe ta dënonin bashkësinë muslimane dhe veprimin antimusliman e kanë bërë intelektualisht të pranueshëm. Kështu e kanë fuqizuar kredibilitetin e udhëheqësve të ideologjisë nacionaliste dhe bindjen që ajo ka përfituar përkrahjen e publikut serb.

Në sajë të asaj që janë duke krijuar ekspertë përmoterien përkatëse, ajo çfarë kanë ofruar orientalistët serbë ishte armaturë e kuqe intelektuale përmjet ideologjinës nationaliste serbe, të krijuar në segmentin e aplikimit mbi muslimanët. Siç thekson sociologu Leo Kuper, përmjet realizimin e gjenocidit, zhvillimi i ideologjisë është veçanërisht i rëndësishëm, në atë masë sa janë të nevojshëm udhëheqësi dhe arsyetimi:

“Të paktën, kur veprojnë kolektivisht, atyre (autorëve të gjenocidit) u nevojitet ideologja përmjet legjitimuar sjelljen e vet, sepse pa këtë ata vetvetën dhe njëri tjetrin do të detyroheshin ta shihnin ashtu siç me të vërtetë janë: hajna të zakonshëm dhe vrasës.”<sup>69</sup> Duke i siguruar bazat intelektuale të kampanjës kundër islamit, orientalistët serbë i kanë kristalizuar dhe fuqizuar stereotipet e gjeneraliuara dhe e kanë siguruar racionalizmin përmjet gjitha masat, të cilat pushteti serb do të mund t'i ndërmerrte kundër muslimanëve, duke u përpjekur t'i realizonte qëllimet e veta politike. Kështu, orientalistët ndihmuani që gjenocidi të bëher realitet.

<sup>69</sup> Leo Kuper, *Genocide: its political use in the twentieth century* [Gjenocidi: Shfrytëzimi i tij në qëllimet politike në shekullin njëzet], Yale University Press, New Haven 1981, p. 84.

## Gjasat për ardhmëri

Bile, edhe nëse më në fund gjendet zgjidhje politike në Bosnjë dhe Hercegovinë, dëmi, gjithsesei, tani është shkaktuar. Por edhe nëse muslimanët do të mbroheshin atje, ata në Jugosllavinë e cunguar (Serbinë dhe Malin e Zi) do të mbesin të jetojnë në rrezik, por është më se e vërtetë se serbët kanë për ta rifilluar spastrimit etnik me përmasa masovike.

Rekomanduesit e Serbisë së Madhe e shprehin indisponimin e vet të shkaktuar me faktin që pakicat e përbëjnë pjesën e konsiderueshme të popullatës në Jugosllavinë e cunguar dhe dukshëm do të dëshronin që të lirohen nga ajo. Kjo veçanërisht vlen për numrin e madh të muslimanëve që janë duke jetuar në Serbi dhe Mal të Zi: gati dy milionë Shqiptarë, të cilët janë duke jetuar në Kosovë (nëntëdhjetë për qind e të cilëve janë muslimanë), nëpër pjesët e Malit të Zi, muslimanët boshnjakë të Sanxhakut dhe Romët muslimanë të shpërndarë anembanë Jugosllavisë së cunguar.

Edhe pse këto territore janë pushtuar gjatë luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913, edhe pse popullata e tyre që nga ajo kohë është nën presion të shpërnguljes, dhuna është intesifikuar kaherë. Ekzistojnë shumë tregues që procesi i njëjtë i definimit dhe separatizimi i Shqiptarëve dhe muslimanëve të tjerrë të mbetur në Jugosllavinë e cunguar, me Islamin si komponentë kyqe e “llojullojshmërisë” së tyre, përsëri – pas pushimit të shkurtër, kur fokusi serb ishte përqëndruar në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë – përfiton në forcë, politikisht e edhe intelektualisht. Është më se e vërtetë që këto argumente shërbijnë si përgatitje arsyetimi për sulm të ngjashëm me atë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Deri tani, ky proces në Sanxhak dhe në Kosovë kryesisht ka pasur formën e “spastrimit të heshtur etnik”, strategjisë e cila bazohet mbi të jetuarit ekstremisht të vështirë për muslimanët e Sanxhakut dhe Shqiptarët, me shpresë të dukshme që ata do të jenë të detyruar për të shkuar.

Kjo merr formën e rrahjes dhe burgosjes nga ana e policisë, pastaj maltretime nga ana e pushtetit dhe grupeve militante.

Në Kosovë, njerëzit pushohen nga puna, duke i përfshirë shumicën profesionalistë, suprimohet sistemi i mbrojtjes shëndetësore, mbyllen organizatat kulturore lokale dhe demontohet sistemi arsimor në gjuhën shqipe.

Eshtë për të pritur që orientalistët serbë kanë për t'u kyqur në kampanjën antiislamike e cila udhëheqet në Serbi. Ata, tanë janë duke ndihmuar përgatitjen e rastit të ngjashëm me atë në Bosnjë dhe Hercegovinë, e që do të mund të ishte si arsyetim për marrjen e masave më të rrepta mbi territorët e tjera. Për shembull, Jevtiqi pohon “çështë veçanërisht me rëndësi” që të gjitha anketat tre-gojnë që Shiptarët jugosloven (term përbuzës serb për shqiptarët edhe pse rrjedh nga burimi autentik i etnicitetit për Shqiptarët – Scipetar – bir i shqiponjës) janë më të lidhur me Islamin sesa serbët e turqizuar (muslimanët Boshnjak). Prandaj, rrënjet e ‘revolucionit Islamik’ janë filiza edhe në Kosmet”.<sup>70</sup> Ai, gjithashtu, ishte kritik ndaj shqetësimit ndërkombëtar për burgosjen e liderëve muslimanë (apo siç i quan ai “ekstremistëve”) në vitin 1994 në Sanxhak dhe thërret pushtetmbajtësit serbë që përkundër përgjigjeve, të reagojnë ashpër në përzierje nga jashtë në diç që ai rreptësisht e konsideron si çështje

